


Siguri

Mister në Hajvali | Familja kthehet pas tri ditësh dhe gjen plumbin në dritare – një dëshmitar kishte dëgjuar të shtëna



Sinjali.com

29 Gusht 2026 11:26



Një predhë e shkrepur nga një armë zjarri ka përfunduar në dritaren e një shtëpie në Hajvali të Prishtinës, në një rast që për momentin mbetet i mbështjellë me pikëpyetje. Askush nga familjarët nuk ndodhej në shtëpi kur dyshohet se ka ndodhur incidenti dhe ende nuk dihet kush qëllloi, nga çfarë arme dhe nëse shtëpia ishte cak i qëllimshëm, raporton Sinjali.

Rasti është zbuluar vetëm pasi familja është kthyer në shtëpi.

Burimet e Sinjalit bëjnë me dije se M.H ka deklaruar para Policisë se familja ishte larguar nga shtëpia më 25 gusht dhe nuk ishte kthyer deri më 28 gusht.

Me t'u kthyer, ajo ka vërejtur diçka të pazakontë në një prej dritareve.

Roleta ishte dëmtuar, ndërsa në të ishte gjetur një predhë.

Siç mëson Sinjali, policia është njoftuar të premten, më 28 gusht, rreth orës 17:30 dhe njësitë policore kanë dalë në rrugën "Minatori" në Hajvali.

Nga ekzaminimi fillestar është konstatuar se dëmtimi dyshohet se është shkaktuar nga një predhë e shkrepur nga armë zjarri. Në vendngjarje kanë dalë edhe hetuesit, të cilët e kanë sekuestruar predhën, ndërsa lloji i armës nga e cila është shkrepur ende nuk dihet.

Por hetimet kanë nxjerrë edhe një detaj tjetër.

F.H i intervistuar në cilësinë e dëshmitarit, ka deklaruar se një ditë më parë, më 27 gusht, rreth orës 08:00, kishte dëgjuar të shtëna me armë zjarri, ndonëse sipas tij ato vinin nga një distancë më e largët.

Në këtë fazë nuk është konstatuar nëse të shtënat që ka dëgjuar dëshmitari kanë lidhje me predhën e gjetur në dritaren e shtëpisë.

Pikërisht kjo është një nga çështjet që pritet ta sqarojë hetimi: kur është qëlluar, prej nga ka ardhur predha dhe nëse bëhet fjalë për një goditje aksidentale apo për veprim të qëllimshëm.

Për rastin është njoftuar Prokurori kompetent dhe, me udhëzim të tij, është iniciuar procedura për veprën "Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm".

Deri më tani nuk është identifikuar personi që dyshohet se ka shtënë, ndërsa rasti mbetet nën hetime.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Armë

Dëshmitar

dritare

Familja

hajvali

plum

Sinjali

Të shtëna

tri ditë

Të tjera:



Nesër kufizohet qarkullimi i kamionëve mbi 20 tonë në autostradë

Kosovë



Kosova kërkon ndërhyrjen e BE-së dhe SHBA-së për mbrojtjen e shqiptarëve në Luginë

Politikë



DASH: Hezbollahu merr urdhra nga Irani, bisedimet mund të nisin pasi të çarmatoset

Botë



Arsenali heq dorë nga Alvarez, futet në garë për talentin belg

Futboll



Kurti pas takimit me Abdixhikun: Kur të kemi rezultate, do të kemi lajme për ju

Politikë



Zjarr fushor në Preoc, zjarrfikësit: Është lokalizuar

Siguri



Kurti dhe Abdixhiku takohen sërish për çështjen e Presidentit

Politikë



Shpërthen bombola e gazit në një banesë në Lezhë, dyshohet për gjashtë të lënduar

Shqipëri

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhome Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera

